



Lezhë,
6/11/2019

*Meshtarëve, Rregulltarëve/reve
dhe punëtorëve baritorë*

Objekti: **SIMPOZIUM ME TË RINJTË - 9 dhjetor 2019.**

Në shtator të 2018, me Kushtetutën Apostolike *Episcopalis communio*, Papa Françesku e ka ripërtërirë thellësisht sinodin e Ipeshkvinjve, duke e paraqëtur si një proces të artikuluar në tre faza: **faza përgatitore**, në të cilën bëhet konsultimi i Popullit të Hyjit mbi tema të treguara nga Ati i Shenjtë; **faza kremtuese**, e karakterizuar nga mbledhja asambeare e Ipeshkvinjve; **faza aktualizuese**, në të cilën përfundimet e Sinodit të miratuara nga Ati i Shenjtë duhet të pranohen nga Kishat. Faza qëndrore, në të cilën zhvillohet vepra e shoshitjes së Barinjve, është në një mënyrë të tillë e paraprirë dhe e ndjekur nga faza që i referohen tërësisë së Popullit të Hyjit, në pluralitetin e komponentëve të tij.

Edhe në Kishën tonë të Shqipërisë, pikërisht me rastin e Sinodit të kaluar të Ipeshkvinjve në 2018 mbi të rinjtë, i cili kishte si temë *“Të rinjtë, feja dhe shoshitja thirrore”*, kemi ndjekur sugjerimet e Atit të Shenjtë.

Faza përgatitore ka filluar që në vitin baritor 2017-2018: duke përdorur pyetsorin e paraqitur në Dokumentin Përgatitor, kami “dëgjuar zërin” e rreth 250 të rinjve në 6 dioqezat tona, dhe me ndihmën e *“MËL-Mary Ēard Loreto Foundation”* kemi mbledhur, duke analizuar dhe paraqitur këto të dhëna në një libër të vogël *“Besimi i të rinjve katolik. Analizë mbi Qëndrimet dhe Perceptimet e të Rinjve ndaj Besimit”*.

Me këtë material në dispozicionin tonë, me 8 shtator të vitit 2018 kemi kremtuar FORUMIN për të RINJTË, në të cilin ishin të ftuar të gjithë ata që, në Kishën e Shqipërisë, janë të angazhuar sipas roleve të ndryshme dhe në fusha të ndryshme në shërbim të të rinjve që jetojnë në zonat tona baritore.

Puna që në të gjithë këta muaj ka ardhur duke u pjekur është paraqitur nga Ipeshkvi imz. Ottavio Vitale, i cili pikërisht ka marrë pjesë në Sinodin e Ipeshkvinjve në Romë, në **fazën kremtuese** të sinodit.

Tani, pas kremtimit të Sinodit të Ipeshkvinjve dhe pas publikimit të Nxitjes Apostolike pas-

sinodale *“Christus vivit”* e Papa Françeskut, jemi gati të fillojmë së bashku, me Kishën e Shqipërisë, **fazën aktualizuese** të Sinodit.

Në dritën e ecjes së bërë si Kishë e Shqipërisë në këto vite dhe të mësimëve që na kanë ardhur nga etërit sinodalë si edhe nga Ati i Shenjtë Papa Françesku, duam me të vërtetë të vazhdojmë, të ringjallim dhe të ripërtërijmë, shërbimin tonë që si Kishë dëshirojmë t’ua ofrojmë të rinjve shqiptarë.

Është ky motivi i organizimit të **“SIMPOZIUMIT me të RINJTË”**, që do të mbahet të hënën me 9 dhjetor 2019, si gjithmonë pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në Tiranë.

Simpoziumi i drejtohet, edhe këtë herë, vepruesve baritorë të realiteteve të ndryshme në Kishën e Shqipërisë, por një rol thelbësorë duam t’u japim pikërisht të rinjve (universitarë ose sidoqoftë në mes 18 dhe 30 vjeç), me të cilët duam së bashku të dallojmë se çfarë me të vërtetë konkretisht duhet të bëjë Kisha e Shqipërisë në shërbimin e saj ndaj të rinjve shqiptarë.

Për këtë ***secila dioqezë do të duhet të marrë pjesë në këtë “FORUM me të RINJTË”, me një numër të konsiderueshëm të të rinjve.*** Duke konsideruar që në disa dioqeza prania e universitareve është më e shumt se në të tjerat, me qellim që të kemi një pjesëmarrje reale, të shumta dhe aktive nga të rinjtë, dioqezat që kanë Universitetet (Shkodër, Tiranë-Durës, Administratura e Jugut) angazhohen për të sjellë të paktën 30/40 të rinj, ndërsa dioqezat e tjera (Sapë, Lezhë, Rreshen) angazhohen për të sjellë sa më shumë të rinj.

Pjesëmarrja nuk është e rezervuar eskuzivisht për të rinjtë katolikë dhe të lidhur me realitetet kishtarë, por është e drejtuar edhe për ata që janë jashtë të ashtuquajturit “rreth i zakonshëm” i aktiviteteve tona: Kisha është në shërbim të të gjithëve dhe shoshitja mbi ecjen e re të Kishës së Shqipërisë duhet të ketë aftësinë dhe guximin që të dialogojë me të gjithë.

Programi i **“FORUMIT me të RINJTË”** parasheh dy momente themëlore:

- Paraqitja e Nxitjes Apostolike pas-sinodale ***“Christus vivit”*** nga ana e Atë **Giacomo Costa SJ**, sekretar i veçantë i Sinodit të Ipeshkvinjve mbi të Rinjtë: ai, përveç paraqitjes së Dokumentit, do të na japë sugjerime praktike mbi përdorimin baritor të përmbajtjeve të kësaj Nxitjeje Apostolike që, si Kishë e Shqipërisë, do të mundemi dhe do të duhet të bëjmë në punën tonë të përditshme me të rinjtë, në nivele të ndryshme, kombëtare, dioqezane dhe lokale;
- ***paraqitja e Veprimit Katolik Shqiptar***, me praninë e presidentit kombëtar të Veprimit Katolik Italian, Matteo Truffelli: prania e Veprimit Katolik në Shqipëri është një realitet tashmë i konsoliduar në disa vende, dhe dëshirojmë që të përhapet gjithnjë e më shumë. Përveç relacionit të fillimit në mëngjes, në pasdite, me ndihmën e Veprimit Katolik tashmë aktiv në Shqipëri, do të jetojmë së bashku disa laboratore për të njohur më thellësisht veprimin baritor të ofruar nga ky realitet.

Më në detaj programi është ky:

- 9.00 Momenti i lutjes
- 9.15 Përshëndetjet nga ana e NUNCIT APOSTOLIK, e imz. FREUDO-s dhe imz. OTTAVIO-s
- 9.30 Relacioni i Atë COSTA GIACOMO
- 10.15 Pyetje në sallë
- 11.00 Pushim
- 11.15 Paraqitja e Veprimit Katolik Shqiptar, me praninë e presidentit kombëtar të Veprimit Katolik Italian, Matteo Truffelli
- 12.15 Pushim
- 12.30 Mesha e Shenjtë e Solemnitetit të Zojës së Papërlyer
(sipas vendimit të Konferencës Ipeshkvnore Shqiptare, Solemniteti i Zojës së Papërlyer do të kremtohet me 9 dhjetor, duke qenë se data 8 i bie të jetë e Diela II e Ardhjes)
Dreka e marrë me vete
- 15.00 Animacion dhe paraqitje në grupe të vogla e veprimit baritor nga ana e të rinjve të Veprimit Katolik Shqiptar.
- 16.00 Momenti përfundimtar përmbledhës

E pranishme do të jetë edhe Radio Vatikani, seksioni Shqipëri.

“Baritorja rinore, ashtu sikurse ishim mësuar që ta çonim përpara, ka pësuar sulmin e ndryshimeve shoqërore dhe kulturore. Të rinjtëm, në strukturat e zakonshme, shpesh nuk gjejnë përgjigjë ndaj shqetësimeve të tyre, ndaj kërkesave të tyre, ndaj problematikave dhe plagëve të tyre. Shumimi dhe rritja e organizatave me karakter kryesisht rinor mund të interpretohen si një veprim i Shpirtit që hap rrugë të reja. Megjithatë, është e domosdoshme të thellohet pjesëmarrja e tyre në baritoren e tërësishme të Kishës, si edhe gjithashtu një bashkim më i madh mes tyre brenda një koordinimi më të mirë të veprimit. Edhe pse nuk është gjithmonë e lehtë t'i takojmë të rinjtë, jemi duke u rritur në dy aspekte: vetëdija se është e gjithë bashkësia që i ungjillëzon dhe urgjenca që të rinjtë të jenë më shumë protagonistë në propozimet baritore” (Christus vivit, 202).

Këto fjalë me të cilat Ati i Shenjtë çel kapitullin e shtatë të Christus vivit, që i kushtohet pikërisht “Baritores së të rinjve”, le të na drejtojnë që të vihem në gatishmeri me entuziazëm – e nëse është e nevojshme edhe të na zgjojnë edhe nga një farë mosinteresi – për të kremtuar këtë “SIMPOZIUM me të RINJTË” në mënyrë aktive dhe si Kishë e Shqipërisë që dëshiron me të vërtetë të jetë në shërbim të të rinjve tanë shqiptarë.

Në pritje që t’ju takoj, ju bekoj atësisht në Krishtin Jezus,

Imzot Ottavio Vitale, RCJ